# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6311
E mërkurë, 12 maj 2021
çmimi 0.40


## Kryediplomati gjerman, Kurtit: Dialogu me Serbinë, vendimtar për përparimin e Ballkanit

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KOSOVA KA FILLUAR PËRGATITJEN PËR PËRPILIMIN E PADISË PËR GJENOCID KUNDËR SERBISË FAQE 4-5

# KËRKOHET TË PUNOHET EDHE NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR PËR TA PADITUR SERBINË



Republika e Kosovës ka filluar përgatitjet për ta paditur Serbinë për gjenocid gjatë luftës në Kosovë. Njohësit e çështjeve juridike kanë ftuar qeverinë që të punojë ngadalë dhe fort për këtë padi. Sipas tyre, përveç mbledhjes së provave, qeveria duhet të punojë edhe në rrafshin ndërkombëtar për ta paditur Serbinë për gjenocid. Ata kanë thënë se hedhja poshtë e kësaj padie nga GjND-ja do të sillte pasoja për Kosovën

## INSTITUTI EPIK ANALIZON PROGRAMIN E QEVERISË KURTI: 165 ZOTIME MES IDEALES DHE TË (PA)MUNDURËS



Analizë e KMDLNj-së

## TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË, MUNDËSITË DHE PENGESAT

## OPINION

### STRATEGJIA E SHËRBIMIT SEKRET SERB PËR TA SHKATËRRUAR STRUKTURËN E UÇK-SË PAS VITIT 2000 E KËNDEJ (2) F. 10

Faton B. MEHMETAJ



## AKTUALE



### INFERMIERËT KËRKOJNË RRITJEN E PAGAVE DHE SHTESAVE PËR KUJDESTARI TË NATËS F. 3

### NAGAVCI: RRITJA E CILËSISË NË ARSIM, PRIORITET I MASHTI-it F. 3

## EKONOMI

### MINISTRIA E MJEDISIT ANULON NJË TENDER, DURMISHI: I SHPËTUAM 22 MILIONË EURO F. 9

### KOSOVA DHE ZVICRA NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE F. 9




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Bota bën thirrje për ndalje të dhunës në konfliktin izraelito-palestinez

JERUSALEM, 11 MAJ - Shtete nga e gjithë bota kanë bërë thirrje për qetësi pas disa ditëve të trazirave që janë kthyer në sulme hakmarrëse nga izraelitët dhe palestinezët. Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar i kanë bërë thirrje Izraelit dhe palestinezëve që t'i ulin tensionet sa më shpejt që është e mundur.

Dhuna është përshkallëzuar në mbrëmjen e së hënës pasi militantët palestinezë kanë gjuajtur raketa drejt Jerusalemit. Si përgjigje, ushtria izraelite ka nisur sulme ajrore kundër shënjestrave të militantëve në Rripin e Gazës.

Zyrtarët shëndetësorë palestinezë në Gaza kanë thënë se 22 persona, përfshirë nëntë fëmijë, kanë vdekur në sulme.

Ushtria e Izraelit ka thënë se të paktën 15 anëtarë të grupit të Hamasit, që drejtojnë Gazan, kanë qenë në mesin e të vdekurve. Hamasi ka kërcënuar me sulme, pasi qindra palestinezë janë plagosur në përleshjet me policinë izraelite në një qendër të shenjtë në Jerusalem, ditën e hënë. Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se Hamasi ka "kaluar linjën e kuqe" dhe se Izraeli do të përgjigjet me "forcë të madhe". Në ditët e fundit është parë dhuna më e madhe ndër vite në Jerusalem, me përleshje në mes të policisë izraelite dhe protestuesve palestinezë në pjesën e vjetër të qytetit të Jerusalemit. Përleshjet kanë nisur pas rritjes së zemërimit të palestinezëve rreth kërcënimeve për dëbime të familjeve nga shtëpitë e tyre në Jerusalemin Lindor nga ana e izraelitëve.



Kjo pjesë e qytetit konsiderohet kryesisht arabe. Më herët gjatë ditës së martë, grupi humanitar Gjysmëhëna e Kuqe palestineze ka thënë që më shumë se 700 palestinezë janë plagosur në përleshjet me forcat e sigurisë izraelite në Jerusalem dhe në zonën e Bregut Perëndimor. Bombardimet nuk janë ndalur gjatë natës, pasi zhurma e raketave palestineze dhe sulmeve ajrore izraelite është dëgjuar në këto rajone të martën në mëngjes.

Ushtria izraelite ka thënë se ka kryer sulme në 139 shënjestra në gjithë Rripin e Gazës. Në një sulm një grua është vrarë dhe dy janë plagosur, kanë thënë zyrtarët shëndetësorë. Ndërkohë, Hamasi ka lëshuar raketa në qytetin Ashkelon, në jug të Izraelit. Ai ka thënë se sulmi ka qenë hakmarrje ndaj sulmit izraelit në një bllok civil afër qytetit të Gazës. Një burim nga Hamasi i ka thënë BBC-së në mëngjesin e së martës që më shumë se 300 raketa janë hedhur nga Gaza në 12 orët e fundit.

### Si po reagon bota?

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Hamasi duhet t'i ndalë sulmet me raketa "menjëherë", duke shtuar se të gjitha palët duhet t'i ulin tensionet.

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, ka bërë të njëjtat thirrje, duke thënë se presidenti amerikan Joe Biden është i shqetësuar seriozisht për dhunën.

Sekretari i Jashtëm britanik, Dominici Raab, ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se sulmet me raketa "duhen të ndalen", duke bërë thirrje për ndalje të shënjestrimit të popullsisë civile. Shefi për Politikë të Jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se "rritja e shkallës së dhunës" në Bregun Perëndimor, Gaza dhe Jerusalemin Lindor "duhet të ndalet menjëherë".

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka mbajtur një takim urgjent të hënën për shkak të situatës së krijuar, mirëpo asnjë deklaratë nuk është lëshuar pas takimit. Një diplomat i ka thënë agjencisë së lajmeve "Associated Press" se Kombet e Bashkuara, Egjipti dhe Katari, që shpesh ndërmjetësojnë në mes të Izraelit dhe Hamasit, janë duke tentuar t'i ndalin luftimet.

### Pse Jerusalemi është në qendër të tensioneve?

Ky qytet me disa zona të shenjta është qyteti më i ndjeshëm në konfliktin që ka zgjatur për dekada në mes të izraelitëve dhe palestinezëve. Përveç rëndësisë fetare dhe pretendimeve kombëtare, Izraeli ka aneksuar Jerusalemin Lindor dhe e konsideron gjithë qytetin si kryeqytet të vetin, ndonëse një gjë e tillë nuk njihet nga shumë shtete të tjera.

Palestinezët pretendojnë se gjysma lindore e qytetit do të jetë kryeqyteti i shtetit që dëshirojnë ta kenë në të ardhmen. Zona kodrinore ku kanë nisur përleshjet është e rëndësishme si për hebrenjtë ashtu edhe për myslimanët.

E njohur nga myslimanët si Haram al-Sharif, kjo pjesë e qytetit konsiderohet si vendi i tretë më i shenjtë në Islam, derisa për hebrenjtë është pjesa më e shenjtë dhe njihet si Mali i Tempullit.

Izraelitët kanë thënë se dhuna aktuale është planifikuar më herët nga ekstremistët palestinezë, ndonëse një seri veprimesh kanë nxitur trazirat në Jerusalem.

Të hënën, një marsh i planifikuar nga nacionalistët izraelitë, që parashihte parakalimin në zonat myslimane në Jerusalemin Lindor, është anuluar për shkak të shqetësimeve për dhunë.

Përmes këtij marshi çdo vit shënohet pushtimi i Jerusalemit Lindor nga Izraeli më 1967. Shumë palestinezë e shohin këtë marsh si provokim. Marshi i këtij viti do të zhvillohej edhe në ditët e fundit të Muajit të shenjtë të Ramazanit./Rel/

# ShBA-ja miraton vaksinën "Pfizer" për adoleshentët deri në 15 vjeç

UASHINGTON, 1 MAJ - ShBA-ja ka autorizuar vaksinën "Pfizer" për fëmijët nga 12 deri në 15 vjeç. Administrata e Ushqimit dhe Barnave (FDA) tha se ishte "një hap i rëndësishëm në luftën kundër pandemisë Covid-19". Komisionarja e FDA-së, dr. Janet Woodcock, ka thënë se lëvizja ka për qëllim "të na sjellë afër kthimit të normalitetit dhe t'i japë fund pandemisë". "Prindërit dhe kujdestarët mund të jenë të sigurt se agjencia ndërmori një rishikim rigoroz dhe të plotë të të gjitha të dhënave në dispozicion, siç kemi bërë me të gjitha autorizimet tona të përdorimit të urgjencës së vaksinës Covid-19", ka thënë ajo.

Vendimi pason një provë klinike nga "Pfizer dhe BioNTech" që përfshin 2 260 fëmijë të moshës 12-15 vjeç. Pjesëmarrësit kanë marrë një ose dy doza të vaksinës. Kujtojmë se në ShBA deri më tani janë administruar rreth 260 milionë doza të vaksinave kundër Covidit.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kryediplomati gjerman, Kurtit: Dialogu me Serbinë, vendimtar për përparimin e Ballkanit

**Prishtinë, 11 maj (ER)** - Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Heiko Maas, ka zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ministra e Jashtme e Gjermanisë ka njoftuar se Massi ka thënë se vendi i tij do që të sigurojë një perspektivë brenda Bashkimit Evropian (BE) për shtetet e Ballkanit Perëndimor. "Organizata qeveritare e Gjermanisë është një përparësi kryesore për Gjermaninë që të sigurojë një perspektivë brenda Bashkimit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor", citohet t'i ketë thënë ministri Maas, kryeministrit Kurti.

Në këtë kontekst, ai ka theksuar se dialogu me Serbinë, i udhëhequr nga BE-ja, mbetet vendimtar për përparimin e Ballkanit. "Dialogu mbi normalizimin me Serbinë i udhëhequr nga BE-ja është vendimtar për këtë qëllim", ka theksuar ministri Mass.



# Nagavci: Rritja e cilësisë në arsim, prioritet i MAShTI-it

**Prishtinë, 11 maj (ER)** - Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), Arbërie Nagavci, ka marrë pjesë në debatin e organizuar të martën nga Lëvizja FOL. Në këtë debat, Nagavci ka thënë se prioritet i tyre në këtë fazë është menaxhimi i situatës së shkaktuar nga pandemia duke analizuar pasojat për një periudhë afatgjatë.

Më tutje, ajo ka thënë se MAShTI synon gjithëpërfshirjen, digjitalizimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit




"Prioritete tona do t'i përmendja që nga menaxhimi i situatës me pandeminë. Duhet të jemi të vëmendshëm me pasojat që do të lë pandemia në afat më të gjatë. Tani kemi filluar me mësimin plotësuese. Në përgjithësi kemi pesë qëllime strategjike duke filluar prej arsimit gjithëpërfshirës dhe të digjitalizuar, përshtatjen e shkollave profesionale me tregun e punës e rritjen e cilësisë në arsim", ka thënë Nagavci, duke bërë me dije se do të bëhet rikualifikimi i mësimdhënësve.

"Ne synojmë që të ofrohet një përfshirje e fëmijëve në shkollimin e hershëm duke ndërtuar çerdhe të reja. Do të bëhet rikualifikimi i mësimdhënësve që do të mbesin pa norma. Kemi planifikuar shujta për nxënës, që të ketë barazi për të gjithë fëmijët. Kemi shqyrtuar largimin e notimit", ka thënë ajo.

Ndërsa sa i përket arsimit të lartë, Nagavci ka thënë se synojnë të ketë integritet e autonomi të plotë. "Në arsimin e lartë synojmë një integritet. Do të ndihmojnë në një autonomi të plotë për përmirësimin e cilësisë. Kemi filluar disa procedura që të kemi organe që mundësojnë zhvillimin e inovacionit", ka thënë ajo.

# Infermierët kërkojnë rritjen e pagave dhe shtesave për kujdestari të natës

**Prishtinë, 11 maj (ER)** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në prag të Ditës Ndërkombëtare të Infermierëve, ka pritur të martën një delegacion të Shoqatës së Infermierëve të Kosovës. Përfaqësues të kësaj sindikate kanë njoftuar presidenten Osmani për situatën me të cilën po përballen, duke kërkuar mbështetjen institucionale për plotësimin e kërkesave të tyre.

Ata kanë thënë se rritja e pagës së infermierëve dhe rritja e shtesave për kujdestari të natës do të jetë masa adekuate për ta parandaluar ikjen e infermierëve nga Kosova. Ndërsa presidentja Osmani ka vlerësuar punën e deritashme të infermierëve në përballje me pandeminë dhe ka potencuar se shëndetësia duhet të prioritizohet edhe në aspektin e buxhetimit të saj. Në prag të ditës së tyre, presidentja Osmani ka falënderuar infermierët për punën, duke shprehur nevojën për trajtim të dinjitetshëm të punës së tyre.



# Tre të vdekur, 346 të shëruar dhe 49 raste të reja me Covid në Kosovë

**Prishtinë, 11 maj (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur tre persona të infektuar me Covid-19. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 364 persona dhe janë paraqitur 49 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 1 494 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 49 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 3 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjilan 2 raste (88, 68 vjeç), Prishtinë 1 rast (70 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 106 538 raste nga 557 859 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 2 213 raste të




vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 346 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 98 223 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 102", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prizren 11 raste, Ferizaj 8 raste, Drenas 6 raste, Mitrovicë 4 raste, Podujevë 4 raste, Prishtinë 4 raste, Vushtrri 4 raste, Fushë-Kosovë 2 raste dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Gjilan, Istog, Kamenicë, Pejë dhe Shtime", ka njoftuar IKShPK-ja.



KOSOVA KA FILLUAR PËRGATITJEN PËR PËRPILIMIN E PADISË PËR GJENOCID KUNDËR SERBISË

# Kërkohet të punohet edhe në rrafshin ndërkombëtar për ta paditur Serbinë

Republika e Kosovës ka filluar përgatitjet për ta paditur Serbinë për gjenocid gjatë luftës në Kosovë. Njohësit e çështjeve juridike kanë ftuar qeverinë që të punojë ngadalë dhe fort për këtë padi. Sipas tyre, përveç mbledhjes së provave, qeveria duhet të punojë edhe në rrafshin ndërkombëtar për ta paditur Serbinë për gjenocid. Ata kanë thënë se hedhja poshtë e kësaj padie nga GjND-ja do të sillte pasoja për Kosovën

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 MAJ - Qeveria e Kosovës e ka përfshirë në program qeverisës përgatitjen e padisë ndaj Serbisë për gjenocid në Kosovë gjatë periudhës së luftës. Ndërsa njohësit e çështjeve juridike kanë këshilluar qeverinë se çfarë duhet të ndërmarrë në këtë drejtim. Sipas tyre, për një gjë të tillë duhet të punohet fort në planin e brendshëm për të mbledhur prova dhe në atë jashtëm për të marrë përkrahje ndërkombëtare.

Në ditën që qeveria e ka miratuar planin qeverisës, kryeministri Albin Kurti ka thënë se çështja e padisë për gjenocid para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) do të jetë një nga përparësitë e punës së tij gjatë mandatit qeverisës. "Ne jemi të bindur që Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë në luftën e fundit te ne dhe kjo e meriton një padi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përgatitjen e saj obligim ndaj historisë tonë, ndaj qytetarëve që kanë plagët e hapura dhe që besa edhe ndaj ardhmërisë sonë, që kërkon një shtet demokratik, një shtet të drejtë në të cilin dihet qartë se kush është agresori e kush është viktima", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se përgatitjet për padi janë gjigante sepse një rast i tillë as nuk guxon, as nuk duhet e as nuk mund të humbet.

Edhe ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së, aktualisht udhëheqës i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", Bardhyl Mahmuti, ka thënë se nuk është vonë për ta paditur Serbinë për gjenocid. Ai ka porositur spektrin politik që të flasin me një gjuhë lidhur me këtë çështje. "Jo. Nuk jemi vonuar për të bërë padinë për gjenocidin serb ndaj shqiptarëve në Kosovë. Përkundrazi, në kontekstin politik dhe shoqëror nëpër të cilin kalojmë, çdo përshpejtim i akuzës do të kishte qenë në favor të Serbisë. Të mos harrojmë se edhe në mesin tonë nuk ka konsensus rreth kualifikimit të asaj që ka ndodhur në Kosovë gjatë luftës. Njëri godet thumbin e tjetri patkoin. Me keqardhje duhet të pranojmë se një numër i konsiderueshëm i politikanëve dhe gazetarëve që kanë një rol të madh në krijimin e opinionit publik nuk e kanë të harmonizuar terminologjinë që përdorin kur bëhet fjalë për krimet serbe në Kosovë", ka deklaruar Mahmuti për gazetën "Epoka e re".

Ai ka thënë se duhet të punohet për përgatitjen e padisë, por tani nuk është koha e duhur që Kosova ta paditë Serbinë. Sipas tij, në rrafshin ndërkombëtar gjendja është tejet e pafavorshme për ta bërë një gjë të tillë. "Me keqardhje duhet të pranojmë se një numër i konsiderueshëm i politikanëve dhe gazetarëve që kanë një rol të madh për krijimin e opinionit publik nuk e kanë të harmonizuar terminologjinë që përdorin kur bëhet fjalë për krimet serbe në Kosovë. Në rrafshin ndërkombëtar gjendja është tejet e pafavorshme për ne. Në vend se të ndëshkohet Serbia për gjenocidin që ka kryer në Kosovë, sot kemi krijimin e një gjykate që do t'i trajtojë sajesat e Shërbimit Sekret Serb kundër UÇK-së. Ai i cili do të kishte ngritur padi kundër Serbisë në këtë kontekst ndërkombëtar do t'i kishte bërë shërbim të madh Serbisë, sepse vendimi do të kishte qenë i disfavorshëm për ne", ka thënë ai.

Ai ka deklaruar se për ta paditur Serbinë për gjenocid qeveria duhet të punojë fort edhe në planin ndërkombëtar. "Për t'i rritur gjasat e realizimit të ngadhënjimit të drejtësisë duhet të punojmë shumë si në rrafshin ndërkombëtar, po ashtu edhe në atë të brendshëm. Në të kundërtën do të korrim rezultate negative. Me një fjalë, ai i cili do të shpejtonte të ngrihej akuza për gjenocid kundër Serbisë, në këtë kontekst të raportit të forcave në skenën politike ndërkombëtare, do të bënte një veprim antikombëtar", ka deklaruar ai.

Më herët, edhe profesori i të Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka kritikuar institucionet e Kosovës që kanë bërë fare pak për argumentimin e gjenocidit serb në Kosovë. Ai pati thënë për gazetën "Epoka e re" se në mungesë të punës të institucioneve në këtë drejtim, sot Kosova nuk ka prova të mbledhura për ta paditur Serbinë në ndonjë gjykatë ndërkombëtare për gjenocid. "Marrë në përgjithësi, të gjitha qeveritë e deritanishme, në aspektin institucional, shumë pak ose fare nuk e kanë bërë punën që është dashur ta bëjnë për mbledhjen e provave për krimet e luftës, sidomos ato për gjenocidin serb në Kosovë", ka thënë Salihu.

Ai ka deklaruar se institucionet e Kosovës menjëherë pas luftës është dashur ta themelojnë Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës. "Institucionet e Kosovës është dashur që menjëherë pas luftës, në vjeshtën e vitit 1999 apo në vitin 2000, të formojnë organ në nivel shtetëror, i cili do të emërohej Institut për Hulumtimin e Krimeve të Luftës ose Departament për Krime të Luftës. Në këtë institut do të duhej të punësoheshin njerëz profesionalë, që kanë përkushtim, ideal dhe bashkëndiejnë dhimbje me viktimat e luftës", është shprehur Salihu, duke treguar se në çfarë kushte do të duhej të punonte ky institut. "Këtij instituti është dashur t'i krijohen kushtet optimale me ndërtesa, me infrastrukturë, me buxhet, në mënyrë që brenda 10 vjetëve, pra deri në vitin 2010, të ishin të evidentuar të gjitha krimet e luftës, e sidomos krimet e gjenocidit serb në Kosovë. Sepse në Kosovë është bërë gjenocid. Pra, gjenocidi është krimi më i rëndë në mesin e krimeve apo

→

**Prishtinë, 10 maj** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është i vendosur që gjatë mandatit të tij qeverisës ta padisë Serbinë për gjenocid në Kosovë gjatë periudhës së luftës. Këtë pikë kryeministri i Kosovës e ka përfshirë në programin e vet qeveritar duke thënë se "çështja e padisë për gjenocid para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) do të jetë një nga përparësitë e punës së tij gjatë mandatit qeverisës". "Ne jemi të bindur që Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë në luftën e fundit tek ne dhe kjo e meriton një padi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përgatitjen e saj obligim ndaj historisë sonë, ndaj qytetarëve që kanë plagët e hapura dhe, qe besa, edhe ndaj ardhmërisë sonë, që kërkon një shtet demokratik, një shtet të drejtë në të cilin dihet qartë se kush është agresori e kush është viktima", kishte thënë kryeministri Kurti pas miratimit të programit qeveritar.
Kryeministri Kurti kishte thënë se përgatitjet për padi "janë gjigante sepse një rast i tillë as nuk guxon, as nuk duhet e as nuk mund të humbet".

### Vuçiqi: Padia, kërcënim dhe as nuk duhet provuar

Paralajmërimi i Qeverisë së Kosovës për padi për gjenocid ndaj Serbisë ka nxitur reagimin e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se "Kosova nuk mund ta bëjë një gjë të tillë meqë nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara". Madje ai i ka rekomanduar Kosovës që mos të provojë ta bëjë një gjë të tillë, duke e cilësuar edhe si kërcënim. "Po kërcënoni Serbinë me gjyq për gjenocid? Mund ta realizoni këtë vetëm përmes një shteti tjetër, që është Shqipëria, e kjo do të thotë bashkim me Shqipërinë. U kërkoj shqiptarëve të Kosovës që të mos e bëjnë këtë", ka thënë Vuçiqi.

### Ekspertët: Pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në padia do të kishte kundërefekt

Njohësit e çështjeve juridike kanë shprehur skepticizëm për nismën e Qeverisë së Kosovës për ta paditur Serbinë për gjenocid në Kosovë, pikërisht duke përmendur faktin që Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe formalisht nuk mund ta bëjë këtë. Kështu i ka thënë "DW"-së Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD).
"Në aspektin formal, Kosova nuk ka kapacitet për të ushtruar padi për gjenocid ndaj Serbisë, padi e cila do të konsiderohej e pranueshme nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Shtetndërtimi i Kosovës është ngushtë i lidhur dhe i varur nga mbështetja dhe ndihma e partnerëve ndërkombëtarë, andaj edhe çdo veprim në këtë drejtim duhet ta ketë vëmendjen e tyre, koordinimin dhe bashkëpunimin. Çdo veprim i njëanshëm i Kosovës pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në, kam frikë se do të kishte kundërefekt dhe do ta vinte Kosovën në një situatë të pafavorshme", ka thënë Ehat Miftaraj. Sipas tij, edhe nëse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do ta padisë Serbinë për gjenocid, kjo mund të sjellë telashe të tjera. "Në aspektin formal Shqipëria ka të drejtë të ushtrojë padi njësoj si çdo shtet anëtar i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por se shtetet e tjera serioze në këtë rast do të hezitonin të ndërmerrnin një hap të tillë duke marrë për bazë lidhjen shumë të afërt dhe vëllazërore që ka Shqipëria me Kosovën", ka thënë ai.

### Mundësia pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Një njohës tjetër i çështjeve juridike, Afrim Hoti, profesor në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se ekziston një mundësi që pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë entitetet e caktuara mund të ngrenë padi, por të cilat paraprakisht obligohen t'u nënshtrohen rregullave dhe procedurave të caktuara të kësaj gjykate. "Është një deklaratë që deponohet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë përmes së cilës Republika e Kosovës, si shtet që nuk është anëtar i OKB-së, deklaron që e pranon autoritetin e gjykatës dhe i pranon vendimet që jepen nga GjND-ja. Këto janë raste shumë të rralla, që njihen si të tilla që statuti i gjykatës e lejon një mundësi të tillë, sikundër që edhe entitetet që kanë pozicion pak a shumë të ngjashëm si Kosova janë të rralla. Juridikisht, palë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë vetëm shtetet e pavarura dhe të cilat njëkohësisht janë pjesë e OKB-së", ka deklaruar Hoti.
Kosova mund ta shfrytëzojë këtë mundësi për të ngritur padi për gjenocid ndaj Serbisë por, sipas Hotit, "duhet bërë një dallim elementar ndërmjet deklarimeve politike dhe deponimit formal", që nuk do të thotë që është përmbyllur procesi. "Ai do të mund të konsiderohet si një veprim juridik, mirëpo për vërtetimin e ekzistimit të krimit duhet të deponohen edhe shumë fakte të tjera për t'i pranuar gjykata", ka thënë Hoti.
Shqiptarët në Kosovë e cilësojnë gjenocid fushatën e forcave serbe të sigurisë gjatë luftës së viteve 1998-1999, ku u vranë mbi 10 mijë veta, mijëra të tjerë llogariteshin të zhdukur, ndërsa mbi 800 mijë shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre.
Në vitin 1999 Kroacia kishte ngritur padi ndaj Serbisë në GjND për gjenocid gjatë luftës së viteve 1991-1995. Në vitin 2010 Serbia kishte paraqitur një kundërpadi ndaj Kroacisë, duke thënë se rreth 200 mijë serbë etnikë janë zhvendosur, kur Kroacia kishte filluar operacionin ushtarak në kërkim të territoreve të pretenduara prej saj. E në vitin 2015 GjND-ja vendosi që as Serbia e as Kroacia nuk kanë kryer gjenocid ndaj njëra-tjetrës. Ndërkaq, sa i përket rastit të Bosnjës e Hercegovinës, përkatësisht rastit "Srebrenica", në vitin 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë kishte konstatuar se vrasjet e rreth 8 000 myslimanëve të Bosnjës në Srebrenicë kanë përbërë gjenocid, por kjo gjykatë ishte shprehur se Serbia nuk e kishte parandaluar gjenocidin, por kishte thënë se edhe se nuk kishte prova të mjaftueshme, Serbia kishte përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë. Në vitin 2017 Bosnja e Hercegovina kishte kërkuar rishikimin e këtij vendimi, por GjND-ja e pati hedhur poshtë këtë kërkesë./DW/

# Instituti EPIK analizon programin e qeverisë Kurti: 165 zotime mes ideales dhe të (pa)mundurës



**Prishtinë, 11 maj (ER)** - Instituti EPIK në publikimin e radhës ka analizuar programin e Qeverisë së Kosovës, të miratuar javën e kaluar, ku kanë radhitur 165 zotimet e qeverisë Kurti 2. Nëpërmjet një komunikate për media ky institut ka sqaruar se qëllimi i publikimit është ta vazhdojnë "traditën e dekonstruktimit të programeve të qeverive nga gjuha abstrakte dhe teknike e tyre në infografikat e qarta, të matshme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë".
"Ne kemi identifikuar 165 masa konkrete për të cilat është zotuar Qeveria e Kosovës në kuadër të programit të saj 2021-2025: nga vaksinimi i 60 për qind të qytetarëve në grupmoshën e atyre që duheb vaksinuar deri në fundin e vitit 2021 dhe arritja e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, e deri te sigurimi i 1 000 bursave studentore për vajzat dhe ofrimit të banimit të përballueshëm për 4 000 familje. Ne kemi tentuar ta bëjmë përzgjedhjen e masave të programit të cilat janë të qarta, konkrete dhe të matshme. Me fjalë të tjera, nuk kemi përfshi masat e programit të cilat në esencë nuk janë masa, por zotime abstrakte, p. sh., 'do ta konsolidojmë funksionimin e kompanive publike', 'do ta thellojmë bashkëpunimin', 'do t'i rishikojmë ligjet/strategjitë/politikat', 'do ta forcojmë/fuqizojmë kapacitetet e institucioneve' etj. Po ashtu, nuk kemi përfshirë masat e programit të cilat përbëjnë detyrat e zakonshëm të qeverisë, p. sh., përmirësimi i llogaridhënies ndaj qytetarëve, rishikimi i proceseve të brendshme dhe aktivitete të ngjashëm", ka njoftuar EPIK-u.
Sipas kësaj analize të publikuar nga EPIK, ministria me më së shumti detyra është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me gjithsej 38 masa, ndërsa ministria që nuk ka paraparë asnjë detyrë konkrete është Ministria për Kthim dhe Komunitete.
Duke pasur parasysh numrin e lartë të zotimeve, EPIK ka përgatitur edhe një listë të zotimeve kyçe që burojnë nga programi qeverisë 2021-2025.
"Kur kemi analizuar programin e qeverisë Kurti 1 jemi pajtuar se titulli më i përshtatshëm do të ishte 'Mision i (pa)mundur'. Për arsye të njëjta sikur atëherë kemi vendosur që titullin të mbajmë edhe për këtë program qeverisës, kjo pasi që programi asokohe, dhe i sotmi, janë diku në mes ideales dhe të pamundurës. Programi përmban masat e duhura, pothuaj në çdo sektor. Sidoqoftë, zbatimi i programit do të varet nga disa të panjohura. Si do të financohen të gjitha 165 zotime? A do të arrijë mazhoranca e re të vaksinojë 60 për qind të qytetarëve deri fund 2021? A do të tregojë qeveria fuqinë e nevojshme politike për ta çkapur shtetin nga grupet e fuqishme të interesit të cilat dëshirojnë të ruajnë status-quonë në shoqërinë tonë? Dhe paralelisht me gjithë këtë a do të arrijë qeveria të avancojë dialogun me Serbinë?", ka njoftuar Instituti EPIK.

Analizë e KMDLNj-së

# Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Kosovë, mundësitë dhe pengesat

**Nga: Behxhet Sh. SHALA, drejtor ekzekutiv Valentina DEMOLLI - KOLIQI, zv. e D. E.**

Hyrje: Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore nga aleatët fitues u themelua Gjykata e Nyrembergut që me një procedurë të shpejtë organizoi procese gjyqësore kundër krerëve nazistë duke shqiptuar dënime shembullore dhe kapitale. Edhe në Tokio vepronte një gjykatë, simotër me atë të Nyrembergut. E veçanta e kësaj gjykate për t'i dënuar krimet e nazizmit ishte se në procese gjyqësore, përveç përgjegjësve të drejtpërdrejtë, në procese gjyqësore u përfshinë të gjitha shtresat e shoqërisë gjermane e që kishin përgjegjësi direkte apo indirekte në krimet e nazizmit. Natyrisht se qëllimi përfundimtar ishte denacifikimi i shoqërisë gjermane dhe sigurimi i paqes për një kohë më të gjatë duke e demilitarizuar Gjermaninë dhe aleatët e saj. Nga aspekti i sigurimit të drejtësisë për viktima dhe nga aspekti i të drejtave të njeriut, Gjykata e Nyrembergut mbetet shembull i cili nuk ka lejuar parcializimin e përgjegjësisë apo përpjekjeve që, për shkak të oportunitetit politik, të ndahet në drejtësi e pjesshme apo selektive.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore janë themeluar dy Tribunale Ndërkombëtare për Krime Lufte; Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë i cili u formua në vitin 1992 dhe u funksionalizua në vitin 1993 me seli në Den Hag në Holandë. Kjo gjykatë ka përgjegjësi për dënim të veprave të rënda të shkeljes së drejtës humanitare në ish-Jugosllavi në vitin 1991, që nga lufta në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni të Veriut dhe në Kosovë.

Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte në Ruandë u themelua në vitin 1994 me seli në Arusha, Tanzani, ndërsa është përgjegjëse për dënimin e veprave të rënda të shkeljes së të drejtës humanitare në Ruanda ku, për afërsisht dy muaj u vranë, ekzekutuan dhe masakruan 800 000 tutsi e që njihet si gjenocid i shpejtë.

Veçori e kësaj gjykate ishte se dhunimi ishte pranuar si krim lufte - gjenocid. Kjo gjykatë ishte paraparë të mbyllej në vitin 2012. Këto dy Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte janë gjykata të formuara adhoc, për një periudhë të caktuar kohore prandaj edhe nuk kanë pasur mundësi t'i trajtojnë të gjitha rastet dhe nuk kanë përmbushur drejtësinë për të gjitha viktimat përkundër faktit se kanë pasur në dispozicion mjete të mëdha materiale (Gjykata për Krime Lufte në Ruanda ka pasur buxhet vjetor prej 90 milionë euro kurse Tribunali i Hagës vetëm në fillimin e saj ka shpenzuar 470 milionë euro).

Për këtë arsye janë krijuar gjykata apo Prokurori Speciale në disa shtete të dala nga ish-Jugosllavia kurse, në Kosovë ekskluzivitetin në këtë fushë e kanë pasur UNMIK-u dhe EULEX-i dhe vetëm pas vitit 2012, me transferimin e disa kompetencave, gjykatat vendore në Kosovë kanë filluar t'i trajtojnë rastet e krimeve të luftës me një kapacitet jashtëzakonisht të reduktuar profesional (mungesë e prokurorëve dhe gjykatësve të specializuar).

Në vitin 2010, në bazë të një raporti politik të senatorit Dik Marti e që u miratua me shumicë votash në Këshillin e Evropës, u formua një Task Force për të hetuar krimet e supozuara të UÇK-së e që pastaj rezultoi me formimin e një gjykate apo Dhoma të Specializuara e që paraqet presedan në tërë botën dhe se në këtë mënyrë e diskrediton skajshmërisht sistemin e drejtësisë në Kosovë duke krijuar përshtypje se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare në ndërkohë që përbërja e kësaj gjykate është 100 për qind e huaj, nga niveli më i ulët e deri në nivelin e vendimmarrjes. Fillimi i kësaj gjykate ishte viti 2010 kurse funksionalizimi u bë në vitin 2018. Buxheti fillestar është 300 milionë euro. Kohëzgjatja e paraparë është 10 vjet.

## Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte në Kosovë në kontekstin aktual politik dhe gjeostrategjik

Siç u cek më lartë formimi i Tribunaleve Ndërkombëtare për Krime Lufte u iniciua dhe u përkrah nga forca të mëdha politike dhe ushtarake të cilat edhe e morën përsipër financimin e saj. Gjyqi i Nyrembergut u formua nga aleatët që e fituan luftën (amerikanët dhe sovjetikët dhe aleatët tjerë dhe në fakt ishte një Gjykatë Ushtarake). Pronësia nuk ishte as gjermane e as japoneze por ishte pronësi ndërkombëtare. Tribunali për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë në Hagë u formua nga Kombet e Bashkuara sikur edhe Gjykata për Krime Lufte në Ruanda që nënkupton gjithashtu pronësinë ndërkombëtare. Dhomat e Specializuara për Kosovën u formua nga Këshilli i Evropës faktikisht e që formalisht u votua në Kuvendin e Kosovës e në këtë mënyrë e mohon se Kosova ka pronësi mbi këtë gjykatë. Edhe gjykatat për Timorin Lindor, Siera Leone dhe rasti Rafik Hariri në Liban kanë pronësi ndërkombëtare e që është përcaktuese për kuantitetin e rasteve të trajtuara që nënkupton se vetëm një numër i vogël i viktimave e realizojnë të drejtën elementare të njeriut, të drejtën për drejtësi. Në Kosovën e pasluftës, gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it, më shumë kanë qenë të interesuara për arrestimin dhe dënimin e shqiptarëve, se të serbëve. Ndonëse në fushën e drejtësisë dhe sidomos e të drejtave të njeriut, parimi i reciprocitetit është i papranueshëm dhe i pazbatueshëm, në Kosovë kemi shpërputhje të madhe; numri i viktimave është 90 për qind shqiptare kurse numri i të arrestuarve dhe të dënuarve serbë, qoftë urdhërdhënës, planifikues apo edhe kryerës nuk e kalon 10 për qind. Kjo shpërputhje është inkurajuese për kriminelët e mundshëm për faktin se e afirmon dhe promovon parimin e pandëshkueshmërisë siç ka ndodhur dhe po ndodhë në Kosovë prandaj është pengesë për ndërtimin e paqes, normalizimin e marrëdhënieve përmes ballafaqimit me të kaluarën dhe filtrimit përmes institucioneve të drejtësisë.

## Cilat janë opsionet për Kosovën?

1. Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Serbisë në Kosovë. Ky është propozim i kryetarit të Kuvendit për të cilën KMDLNj vlerëson se është vështirë të sigurohet përkrahje ndërkombëtare nëse e marrim parasysh kontekstin politik. Së pari, emërtimi eventual i propozuar nuk do të gjejë përkrahje ndërkombëtare. Por edhe nga aspekti i të drejtave të njeriut nuk është i pranueshëm sepse ndanë viktimat dhe të dyshuarit për krime në baza etnike në ndërkohë që KMDLNj angazhohet për të siguruar drejtësi për të gjitha viktimat pa bërë dallime në baza etnike, fetare, moshore, gjinore, bindjeve politike apo statusit në shoqëri sikur që këto kritere vlejnë edhe për ata që kanë planifikuar krimin, e kanë promovuar krimin, nuk e kanë penguar krimin apo edhe e kanë kryer krimin. Së dyti, pronësia përsëri do të mbetej te ndërkombëtarët e që Kosova nuk do të kishte aspak ndikim, si në kuantitetin e rasteve që do të trajtohen ashtu as në kohëzgjatje të punës së kësaj gjykate që do të kishte karakterin ad hoc (kohë e kufizuar) dhe do të kishim një riciklim të Gjykatës së Hagës, UNMIK-ut dhe EULEX-it ku shumë viktima nuk do të gjenin drejtësinë e merituar dhe shumë kriminelë do të mbeteshin të falur për shkak të pamundësisë të trajtohen të gjitha rastet. Pastaj, mbetet dilemë se kush do të sigurojë mjetet financiare. Nëse për Dhomat e Specializuara është dashur të sigurohet buxheti fillestar prej 300 milionë eurosh e që trajton një numër të vogël të rasteve (raporti politik i Dik Martit), merreni me mend se sa mjete duhet të sigurohen për një Tribunal të propozuar e që ka pretendime t'i trajtojë të gjitha rastet e krimeve që i ka bërë Serbia në Kosovë por edhe rasteve kur viktima kanë qenë pjesëtarë të pakicave. Nëse për Dhomat e Specializuara është dashur kohë për funksionalizim prej tetë viteve, atëherë sa kohë do të duhej për formimin e Tribunalit të propozuar?! Vetëm një interes i madh politik ndërkombëtar mund të ndikojë në themelimin e këtij Tribunali e që, për momentin nuk duket në horizont. Sido që të jetë, përkundër rezervave dhe dyshimeve, nëse sigurohet një përkrahje e gjerë ndërkombëtare, atëherë edhe ne e përkrahim këtë propozim, në të kundërtën është humbje kohe. Në kontekstin aktual, nga kjo iniciativë mund dhe do të ketë vetëm përfitime politike për Kosovën në planin ndërkombëtar ndërsa në ndjekjen dhe trajtimin e krimeve, nuk do të ketë përparime të mëdha. Për KMDLNj do të ishte më e pranueshme që të zgjerohen kompetencat e Dhomave të Specializuara edhe për trajtimin e krimeve në Kosovë e që nuk janë trajtuar nga Tribunali i Hagës, UNMIK dhe EULEX-i. Nëse këto dhoma janë pjesë e sistemit të Drejtësisë të Kosovës dhe nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës me ndryshim të Ligjit për këtë Gjykatë Speciale kanë pasur mundësi ta shpërbëjnë këtë gjykatë atëherë është shumë më lehtë amendamentimi i Ligjit me të cilin zgjerohen kompetencat e kësaj Gjykate.

2. Gjykatat hibride në Kosovë: Edhe këto gjykata mund të themelohen në Kosovë dhe të cilat do të kishin përbërje të përziera të trupit gjykues e cila do të përbëhej nga gjykatës vendorë dhe ndërkombëtarë. Për dallim nga gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it, që kanë qenë hibride së fundi por me pronësi ndërkombëtare, gjykatat eventuale hibride që do të formoheshin në Kosovë, në përbërje të saj do të kishin 70 për qind gjykatës vendorë dhe 20-30 për qind vendorë. Pronësia pakontestueshëm do të ishte kosovare. KMDLNj mendon se kjo nuk do të ishte zgjidhje ideale e që do të siguronte drejtësi për viktima e as përgjegjësi për kriminelët mirëpo, në kontekstin aktual është zgjidhje më e mirë, më e pranueshme dhe më e realizueshme se propozimi i parë.

3. Forcimi i gjykatave vendore dhe mekanizmave përcjellës: Për të siguruar drejtësi afatgjate për viktima dhe ndjekje dhe gjykim për ata që planifikuan, urdhëruan, nuk e penguan apo e kryen krimin, KMDLNj mendon se forcimi i mekanizmave të drejtësisë në Kosovë do të ishte më efikasi sepse nuk do të kufizohej në afate dhe do të mbështetej në resurse financiare vetanake. Pasi që kemi të bëjmë me vepra penale që nuk vjetrohen, nuk parashkruhen dhe nuk mund të falen, gjykatat vendore do të ishin mekanizmi i duhur strategjik për realizim të drejtësisë së mohuar për shumicën e viktimave në Kosovë. Me kapacitetet aktuale që i ka në dispozicion Prokuroria për Krime Lufte në Kosovë dhe me gjykatës që janë tani, Kosova, as për tre shekuj (300 vite) nuk do të jetë në gjendje të përfundojë rastet e krimeve të luftës dhe krimeve

→



kundër njerëzimit. Eventualisht, këto gjykata të ridizajnuara në Kosovë do të angazhonin ish-prokurorë dhe ish-gjykatës ndërkombëtarë që kanë përvojë në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës në cilësinë e këshilltarëve dhe jo në cilësinë e anëtarëve të trupave gjykues apo prokurorë. Ridizajnimi i këtyre mekanizmave vendorë nuk merr shumë kohë, nuk është i kushtueshëm sepse ata edhe ashtu marrin rrogë nga buxheti i Kosovës dhe vetëm duhet një seri e trajnimeve shtesë për ata që nuk e kanë përvojën e duhur në këtë lëmi. Për fillim, ky mekanizëm vendorë i drejtësisë do të kishte 20-25 prokurorë të specializuar për krime lufte dhe 40-50 gjykatës. Do të duhej të përfillej kriteri etnik dhe gjinor i këtij mekanizmi të drejtësisë.

4. Si mekanizëm përcjellës dhe ndihmues do të ishte themelimi i një komisioni i cili do të verifikonte të dhënat e grumbulluara deri më tani nga OJQ-të, institucionet shtetërore, komunat, organizatat ndërkombëtare, OSBE, UNHCR dhe burimet tjera. Në fakt, ky komision i formuar nuk do të kishte nevojë të nisë punën nga e para por se do të merrej vetëm me raste kur ka mëdyshje dhe të cilat nuk përputhen me të dhënat e grumbulluara nga shumë faktorë. Në këtë Komision do të angazhoheshin ekspertë të profileve të ndryshme, studentë vullnetarë të profileve të duhura ndërkaq do të mbikëqyrej nga një trup, ta themi prej 5 anëtarëve e që kanë përvojë të gjatë dhe ekspertizë të dëshmuar në trajtimin e këtyre rasteve.

"Ringjallja" e Institutit për Hulumtim të Krimeve të Luftës, në çfarëdo forme, për KMDLNj paraqet humbje kohe dhe riciklim të një pune që nuk është bërë si duhet.

Krimet e kryera në Kosovë dhe sanksionimi i tyre: Në Kosovë gjatë luftës 1998 -1999 janë kryer krime që sanksionohen sipas të drejtës ndërkombëtare:

1. Janë kryer krime të rënda të Drejtës Humanitare

2. Janë bërë shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës të vitit 1949: a) vrasje me qëllim, b) tortura dhe trajtim jonjerëzorë përfshirë edhe eksperimente biologjike, c) janë shkaktuar me qëllim vuajtje të rënda apo dëmtim i shëndetit fizik dhe mendor, d) është shkatërruar apo përvetësuar pasuria që nuk kushtëzohet me nevoja ushtarake, në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare, e) janë detyruar robërit e luftës dhe civilët t'i shërbejnë forcave armiqësore, f) u janë mohuar robërve të luftës e drejta për një proces gjyqësorë të drejtë dhe të paanshëm, g) ka ndodhur deportimi i dhunshëm i popullatës që për qëllim ka pasur spastrimin etnik dhe h) janë marrë peng civilët e pafajshëm dhe janë dërguar në një shtet tjetër.

3. Shkelja e zakoneve të luftës: a) janë përdorur helme të ndaluara dhe armatim për shkatërrim në masë për të shkaktuar vuajtje të mëdha, b) janë shkatërruar qytete dhe fshatra që nuk arsyetohen me nevoja ushtarake, c) janë sulmuar dhe bombarduar me çfarëdo mjeti qytetet dhe fshatrat, objektet dhe ndërtesat e banimit për të shkaktuar sa më shumë viktima dhe më shumë vuajtje, d) janë pushtuar, dëmtuar apo shkatërruar me qëllim objektet fetare, shkollat, objektet e kulturës, akademike, organizatat humanitare, objekte e mbrojtura, janë vjedhur artefaktet, arkiva, spitalet etj., e) është plaçkitur pasuria dhe prona publike dhe private.

4. Është kryer gjenocidi: Në bazë të Konventës për Gjenocid nga viti 1948, gjenocid nënkupton: a) vrasje në masë e një grupi të caktuar, b) shkaktimi i dëmeve të rënda fizike dhe mendore i një grupi të caktuar, c) imponim i qëllimshëm i kushteve të rënda të jetës i një grupi të caktuar e që ka për qëllim asgjësimin e tërësishëm apo të pjesërishëm, d) krijimi i rrethanave me qëllim të pengohet lindja për një grup të caktuar dhe e) transferimi apo deportimi i dhunshëm i fëmijëve të një grupi të caktuar në një grup tjetër, dhe f) skllavërimi, dhunimi seksual apo detyrimi për prostitucion i një grupi të caktuar.

5. Krimet kundër njerëzimit: Në Kosovë janë bërë vepra që hyjnë nën jurisdikcionin e krimeve kundër njerëzimit: a) vrasje dhe vrasje në masë e civilëve dhe pengjeve të luftës, b) asgjësimi i pronës private, publike dhe një grupi të caktuar, c) robërimi, d) deportimi i dhunshëm, e) torturimi, g) dhunimi dhe sklavërimi seksual, h) përndjekja në baza etnike, racore dhe fetare dhe, i) veprime tjera çnjerëzore.

Metodologjia e punës dhe grupet që duhet të trajtohen: Në Kosovë nuk ka nevojë të formohen shumë komisione, task forca apo grupe punuese. Duhet të formohet një Komision qeveritar i centralizuar ku përgjegjësia për tërë procesin i takon Ministrisë së Drejtësisë. Nuk ka nevojë që rishtazi të fillohet me grumbullimin e fakteve për atë që ka ndodhur në luftën 1998 - 1999 sepse merr shumë kohë dhe do të kemi duplifikim të punës. Komisioni qeveritar duhet të verifikojë të dhënat e OJQ-ve që janë marrë me viktima dhe pasoja të luftës dhe në rast të ndonjë lëshimi eventual, mund të bëjë hulumtime që nuk marrin shumë kohë. Lista e të vrarëve që janë përpiluar nga OJQ-të janë të sakta në masën 98 për qind sikur edhe lista e personave të pagjetur.

Duhet të përzgjidhen një numër i caktuar i vrasjeve në masë - masakrave, të riintervistohen dëshmitarët që kanë mbijetuar dhe thuaja në të gjitha rastet e vrasjeve në masë - masakrave ka të mbijetuar që mund dhe duhet të dëshmojnë në seancat dëgjimore sikur që ishte rasti i dëgjimit para Kongresit amerikan i të mbijetuarës së dhunës seksuale, Vasfije Krasniqi - Goodman dhe Ilir Bytyçi.

Në Kosovë mund të sigurohen shumë dëshmitarë mirëpo me kalimin e kohës numri i tyre do të jetë i pamjaftueshëm për të hetuar dhe dënuar krimet e luftës. Lista e këtyre dëshmitarëve do të bëhej më vonë.

Duhet të trajtohet si rast i veçantë masakra në Burgun e Dubravës, mbajtje si pengje lufte të civilëve në Burgun e Lipjanit dhe kampin e Smrekonicës si dhe në burgjet e Serbisë për faktin se të burgosurit dhe robërit e luftës edhe në kohën e veprimeve luftarake gëzojnë mbrojtje të veçantë, në përputhje me detyrimet nga e drejta ndërkombëtare.

Duhet të trajtohet si rast i veçantë edhe bartja e të vrarëve nga Kosova në Serbi, ekzekutimi eventual i të robërve të luftës të cilët janë gjetur në varreza masive në bazën ushtarake në Batajnicë dhe Petrovo Sello sikur edhe të hetohet nëse atyre u janë hequr organet para se të varrosen në varrezën masive në Batajnicë.

Sepse ky rast i krimit nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër të botës.

Duhet të trajtohen si rast i veçantë vrasja e aktivistëve për të drejtat e njeriut, aktivistëve fetarë si dhe grupeve të cenueshme.

Duhet të trajtohen si rast i veçantë vrasja e fëmijëve, grave, të moshuarve dhe të sëmurëve sikur edhe të atyre që për shkak të pamundësisë së marrjes së ndihmës mjekësore apo mungesës së ushqimit kanë vdekur gjatë luftës.

Duhet të trajtohen si rast i veçantë femrat dhe meshkujt viktimë e dhunës seksuale sikur edhe fëmijët e lindur si pasojë e këtyre dhunimeve.

Viktimat që kanë humbur jetën apo janë gjymtuar si pasojë e minimit të hapësirave jetësore nga forcat serbe duhet të trajtohen si rast i veçantë.

Personat me aftësi të kufizuar e që janë vrarë apo kanë vdekur në mungesë të trajtimit mjekësorë janë kategori që duhet të trajtohet seriozisht dhe me përkushtim.

Metodologjia e punës është grumbullimi dhe verifikimi i të dhënave të paverifikuara, intervistimi i dëshmitarëve që janë të domosdoshëm, shënimet nga mediat e shkruara dhe elektronike të kohës, arkivi i UÇK-së, të dhënat e OJQ-ve që janë marrë në mënyrë aktive me viktimat dhe pasojat e luftës dhe të cilët kanë dokumentacion apo të dhëna që e kanë një shkallë të lartë të besueshmërisë, materialet nga Tribunali i Hagës, nga UNMIK-u dhe EULEX-i, nga arkivat në Shqipëri, Maqedoni dhe vendet tjera ku janë strehuar refugjatët, të plagosurit apo ku kanë vdekur.

Duhet të bëhet një listë e objekteve fetare, kulturore, të mbrojtura dhe të tjera që janë shkatërruar nga Serbia në luftën e vitit 1998 - 1999.

Duhet të grumbullohen të dhënat për vjedhje të arkivave, të dhënave kadastrale, vjedhjen e kursimeve pensionale, vjedhjen e kursimeve bankare dhe tjetërsimit të pronës publike dhe private, shkatërrimit të pronës publike dhe private që i ka bërë Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës në luftën e fundit 1998 - 1999.

Partnerët e nevojshëm dhe të domosdoshëm për hetime të krimeve të luftës në Kosovë: Që të kemi një qasje serioze në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit duhet një bashkëpunim i ngushtë i sektorit joqeveritar dhe institucioneve përkatëse qeveritare. Të gjitha OJQ-të që një kohë të gjatë kanë punuar me viktimat dhe i kanë përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e viktimave e që deri vonë kanë qenë burim i vetëm dhe i besueshëm i informatave. Listën e këtyre OJQ-ve dhe institucioneve për të cilat KMDLNj vlerëson se mund të kontribuojnë mund dhe do ta dërgojë më vonë. Nga institucionet vendore Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësorë janë hallkat kryesore e këtij zinxhiri ndërsa Ministria e Drejtësisë e ka çelësin e suksesit apo do ta bartë përgjegjësinë nëse ky proces dështon. Nga institucionet ndërkombëtare duhet veçuar të gjitha ato që kanë vepruar në Kosovë para luftës, gjatë luftës dhe pas përfundimit të luftës e që kanë shumë të dhëna të cilat në mënyrë selektive janë përdorur, kryesisht për qëllime politike siç ishte mbajtja e gjendjes së një paqeje të brishtë apo një status - quoje për t'iu bërë presion palëve gjatë bisedimeve apo marrjeve të vendimeve. Për të ngritur efikasitetin dhe përligjur procesin do të ishte e nevojshme sa më parë të formohet Komisioni për të Vërtetën sikur që është vepruar në të gjitha vendet ku ka pasur luftëra, me pasoja të mëdha dhe ku kemi pasur shkelje të rëndë të së drejtës humanitare dhe zakoneve të luftës. Komisioni për të Vërtetën është mekanizëm jogjyqësor por se ka ndikim të madh në sqarimin e së kaluarës në veçanti por se mund të ndihmojë edhe gjyqësorin duke e furnizuar me të dhëna.

Ky është një elaborim i shkurtër i KMDLNj-së për formimin e Tribunalit Ndërkombëtar apo Kombëtar për Krime Lufte dhe, në fazat e mëvonshme, varësisht si konkretizohet kjo nismë, kontributin do ta japë në përputhje me mandatin që e ka dhe që e ka ushtruar deri më tani përmes bashkëpunimit me Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut, EULEX-it dhe Prokurorisë për Krime Lufte të Kosovës.

# Strategjia e shërbimit sekret serb për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pas vitit 2000 e këndej (2)



Faton B. MEHMETAJ

Shërbimet sekrete serbe dhe njësitë e tyre në Kosovë e kanë arritur edhe një qëllim tjetër, ripushtimin e pjesës veriperëndimore të vendit, në të cilën e vendosën edhe administratën paralele e cila, si e tillë, funksionon edhe sot e kësaj dite. Pas ripushtimit të kësaj pjese shërbimet sekrete serbe, gjithmonë në koordinim me strukturat e tyre që veprojnë në Kosovë, e kanë filluar ofensivën e dytë të ripushtimit të Kosovës edhe në disa pjesë të tjera, fillimisht përmes asociacionit të komunave e ngjashëm. Ka 20 vjet që shqiptarët e paguajnë rrymën që e shpenzon minoriteti serb në Kosovë, edhe pse shumica prej tyre nuk e njohin shtetësinë e Kosovës. Ky është një dhunim i të drejtave të qytetarëve të Kosovës nga BE-ja dhe qeveritë e Kosovës. Enklavat me shumicë serbe po rikonsolidohen në pjesë të ndryshme të Kosovës për projektin e ri të okupimit të pjesëve tjera për t'i avancuar nga administrata e Kosovës. Kjo është e mundshme sepse ndërkombëtarët haptazi po i mbështesin planet serbe për ta dëmtuar procesin e zhvillimit të shtetit të Kosovës. Ky ndikim kaq i madh i shërbimeve serbe por edhe i qeverisë së Serbisë në Kosovë e ka rrezikuar qe 20 vite rresht funksionimin e rendit kushtetues në Kosovë. Shpesh herë u vranë minoritarët serb nga anëtarët e organizatave të fshehta serbe, me qëllim që këto veprime t'ua lënë shqiptarëve, për të arritur efekte politike në instancat ndërkombëtare, për ti paraqitur shqiptarët e Kosovës por edhe institucionet e saj si të pa afta për ta udhëhequr shtetin. Fatkeqësisht në gjithë këtë katrahurë që po ndodhë me vendin tonë, më e keqja e kësaj pune është se po mungojnë edhe deklaratat e ekspertëve të klasës politike kosovare për ti denoncuar këto veprime që janë tepër të dëmshme për Kosovën. Nuk janë të pakt as personat kosovar qe i marrin dy paga, një nga Serbia e tjetrën nga buxheti i Kosovës, por edhe që kanë marrë shtetësinë dhe dokumentacionet e Serbisë. Faktikisht kjo është e drejt e tyre, por është edhe solidarizim me qeverinë e Serbisë. Nga këta njerëz mjaft prej tyre kanë pozita në institucionet e Kosovës. Pas tërheqjes së forcave paramilitare, policore e ushtarake serbe nga Kosova, UNMIK-u e kishte përgjegjësinë për ti punësuar njerëzit në administratën e Kosovës por dhe në vende tjera me përgjegjësi. Ata për ti pamundësuar pjesëtarët e UÇK-së që të punësohen nëpër vende të ndryshme të punës, e vunë si parakusht, se për tu punësuar, kërkoheshin 7 vite përvojë pune. Pra prioritet kishin strukturat e ish-sistemit. Që nga viti 2000 e deri sot jo pak njerëz të punësuar në Kosovë, diplomat e fakulteteve i kanë nga Serbia. Respekt për gjeneratat ma të vjetra që janë shkolluar në Beograd, por fjala është për këta pas vitit 2000 që u shkolluan në Beograd dhe sot kanë pozita të ndryshme në shoqërinë kosovare. Sidoqoftë kualifikimi kudo që të merret e ka vlerën e vet, por është i pa justifikueshëm një veprim i tillë. Sipas disa statistikave tashmë të bëra publike, mbi 43 mijë shqiptarë kanë punuar për shërbimet sekrete serbe. Kjo klasë e shoqërisë në bashkëpunim edhe më shërbimet sekrete serbe dhe klasën politike të Serbisë në të gjitha proceset e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë bënë trysni tek bashkësia ndërkombëtare në dëm të Kosovës duke i dështuar e zvarritur këto procese deri në ditët e sotme. Kjo do të thotë se spiunazhi serb është i infiltruar thellë në aparaturën e shtetit të Kosovës,e nëse nuk vihet nënë kontroll paraqet rrezik të madh, dhe sa më shumë të zvarritet ky problem, aq më vështirë riparohet. Sikurse në vitin 1981, 1990, 1999 e edhe sot, shërbimet sekrete i kanë goditur dhe i godasin strukturat kundërshtare të tyre që janë klasa e veprimtarëve politik, të burgosurit politik, luftëtaret, deputetët e ndërgjegjshëm, strukturat e sigurisë, por edhe popullin që i përkrahin këto struktura. Projekti i shërbimeve sekrete serbe për ti kundërshtuar këto shtresa nuk ishte i kotë por mirë i organizuar, gradualisht i ka arritur efektet e veta. Akuzat, shpifjet, gënjeshtrat dikur nuk kishin ndonjë peshë të madhe, por tani janë bërë "argumente" për ti goditur çlirimtarët. Kurse Serbia dhe bashkëpunëtorët e tyre pos që nuk u ndëshkuan morën privilegje. Si ka mundësi që mbi pesë mijë të zhdukur shqiptar të gjenden në territorin e Serbisë, e gjyqësia ndërkombëtare dhe vendore të heshtin, duke e lënë këtë problematikë kaq të madhe të trajtohet si "çështje teknike" e Beogradit, të cilën e përdorën ata për presione politike. Në anën tjetër nuk u gjurmuan fare një numër jo i vogël i kriminelëve serbë, që figuronin në listat e të zhdukurve pas luftës, duke qenë të njoftuar saktë me dëshmitë e dhëna në UNMIK kundër tyre dhe duke e ditur se një ditë mund të ndiqen penalisht si të dyshuar për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, sapo janë vendosur diku në Serbi, e kanë ndërruar identitetin dhe janë shpallur të zhdukur në Kosovë. Ata (shërbimet serbe) i shfrytëzuan dobësitë e pushtetarëve të Kosovës, mospërvojën e tyre në pushtet, lakminë për pushtet e dobësitë tjera, përmes të cilave i goditen këto struktura në shumë dimensione, duke e bërë edhe shpërqendrimin e një pjese të popullatës prej tyre. Shërbimet sekrete serbe e përdorën këtë shpërqendrim dhe mospërfillje për ti izoluar shtresat politike të cilat kishin dalë nga UÇK-ja. Ky mekanizëm i njerëzve kaq të fuqishëm,përmes shqiptarëve të "ndershëm", kohë pas kohe u bënë gjyqe udhëheqësve të UÇK-së. Dhjetëra herë veteranët e Serbisë dhe pse kishin bërë me qindra krime në Kosovë i kishin mërsyer pikat kufitare Kosovë-Serbi në shenjë kërcënimi e presioni ndaj shtetit të ri të Kosovës. Kjo tregon se shërbimi sekret serb dhe njerëzit e tyre i përdornin të gjitha mekanizmat për ta shkatërruar këtë shtresë të njerëzve. Faktikisht këto mekanizma ekzistonin edhe më herët si pjesë e shërbimeve sekrete serbe. Nga viti 1981 e deri në vitin 1900 ekzistonte Sektori i VIII i ShSSH-së në Kosovë i cili ishte i ngarkuar për vrasjen dhe likuidimin e terroristëve shqiptarë, (bëhet fjalë për shtresën patriotike te shqiptarëve), e ky sektor pas vitit 1990 zëvendësohet me Drejtorinë e 6-të, sektor ky që shërbente për likuidimin e kundërshtarëve politik të Serbisë. Këto shërbime për një kohë i përdorën maksimalisht tipat anacional për veprime kriminale kundër bashkëkombëseve të vet, me qëllim të paralizimit të veprimtarisë patriotike të grupacioneve në Kosovë, shtuan presionet e shantazhet ndaj klasës progresive, i shkatërruan gradualisht institucionet arsimore e kulturore duke mos i lënë anash as ato fetare e informative. Përdorën të gjitha mjetet e mundshme për ta forcuar dhe bërë të qëndrueshëm rrjetin e spiunazhit në Kosovë duke përfshirë këtu Shqipërinë dhe diasporën. Ata me kohë arritën ta inkorporojnë një celulë të tyre në radhët e UÇK-së. Me ndihmën e tyre arritën ti zbulojnë grupet e para që kishin shkuar për të trajnuar për operacione luftarake në Shqipëri si dhe zbuluan dhe arrestuan grupin e Nait Hasanit me shokë që konsideroheshin drejtuesit e UÇK-së. Pas kësaj, në disa prita, shërbimi sekret serb arriti ti vret drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si: Luan Haradinajn në kufirin Kosovë-Shqipëri, Adrian Krasniqin në një aksion në Kliqinë, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha në një pritë të organizuar në Pestovë. Organizuan sulmin mbi familjen e Adem Jasharit dhe Hilmi Haradinajt si dy vatra që kishin marrë organizimin dhe masivizimin e UÇK-së, por edhe goditën kudo strukturën e guerilës shqiptare të UÇK-së. Kjo ishte një goditje e fortë që i ndodhi UÇK-së. Gjatë luftës u bënë tendenca që të krijohen dy krah ushtarak në Kosovë, por edhe u sabotua hapur furnizimi me armatim i UÇK-së. Shërbimi sekret serb kishte arritur t'i futë bashkëpunëtorët e vet edhe brenda grupeve që ishin trajnuar në Shqipëri. Ky shërbim përmes lidhjeve të veta, kishte arritur që ta siguronte listën e personave që ishin trajnuar në Shqipëri nga radhët e UÇK-së. Sigurisht që ata i kanë infiltruar burimet e tyre në këtë organizim sepse pjesëtarët e UÇK-së që morën pjesë në ushtrime në Shqipëri ishin të dekonspiruar dhe se shërbimet sekrete serbe ishte në njohuri të plotë për veprimtarinë e tyre dhe krejt procesin e trajnimit që ishte kryer atje. Siç është bërë edhe publike, shërbimi serb kishte të dhëna të detajuara për trajnimin në Shqipëri, ata dinin edhe numrat e armëve të tyre që i kishin gjatë trajnimit. Lidhjet që i kishte instaluar shërbimi sekret serb brenda këtij grupi e kanë denoncuar edhe Adem Jasharin duke treguar për të sasinë e armatimit dhe numrat e armatimit. Shërbimi sekret serb nuk e kishte ndërprerë veprimtarinë e vet as më vonë kur UÇK-ja ishte legalizuar dhe bënte përgatitje për të hyrë në Kosovë. Bazuar në deklarimet publike të disa pjesëtarëve të shërbimit sekret të zbulimit dhe kundërzbulimit të ish-Ministrit të Mbrojtjes Ahmet Krasniqi, gjatë punës dhe operimit të tyre në Shqipëri, ata kishin gjetur fakte e të dhëna të bollshme se agjenturat serbe kishin arritur të futen brenda njësive të UÇK-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Ata kanë cekur se këto struktura kishin depërtuar në njësitë tona që operonin në Shqipëri. Pos kësaj shërbimi sekret serb kishte arritur ta sabotonte luftën në Kroaci që drejtohej nga njësitë ushtarake që përbëheshin prej shqiptarëve nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës. Edhe ky projekt ishte pjellë e shërbimeve ushtarake serbe që solli pasoja të mëdha. Njësitë operacionale serbe që i organizuan këto veprime ishin po ato që e bënë suspendimin e autonomisë së Kosovës, përçarjen e kuadrove politike të kohës dhe shkatërrimin e institucioneve në atë kohë paralele të Kosovës. Pothuajse të gjitha aktivitetet dhe lëvizjet politike të kohës ishin bërë objekt i përcjelljes dhe i përpunimit sistematik. Në vitet 90-ta kreu i shërbimit informativ serb, Ivica Stanishiq i kishte takuar personalisht një pjesë të mirë të parisë së Kosovës. Shërbimet sekrete serbe ishin mirë të informuara, kishin siguruar kontakte e burime kudo. Ata, me qëllim që t'i monitorimin dhe kontrollonin grupet ilegale por edhe strukturën e UÇK-s në përgjithësi, kishin infiltruar dhe rekrutuar brenda radhëve të UÇK-së rreth 140 persona, kjo shifër është bërë edhe publike si e tillë. Këta persona i shërbyen shërbimeve sekrete serbe, gjatë luftës dhe pas mbarimit të saj.

(Vijon)




Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.
5.99€
ISBN 978-9951-780-56-8
Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE
Mehmet Kraja
HËNA PREJ LETRE
(Drama, trilogji)
ARMAGEDONI


FATMIR LEKAJ
KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET
E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese
Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe për trajtimin e konflikteve, ndërkohë edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, kurse për studime postmagjistraturale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merret me veprimtari të kërkuesit të pavarur dhe të këshilldhënies për çështjet e integrimit etj. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji.

## Lewandowski, besnik i Bayernit

MUNCHEN, 11 MAJ - Robert Lewandowski ishte simboli i Bayern Munchenit një vjet më parë ku gjigantët gjermanë pushtuan botën e futbollit duke fituar gjithçka që ishte në tavolinë, gjashtë trofe nga gjashtë gara. Për fat të keq të sulmuesit polak, "France Futboll" vendosi të mos akordojë atë edicion "Topin e Artë" duke i hequr në këtë mënyrë të drejtën të fitonte për herë të parë trofeun më të rëndësishëm në rang individual. Lewandowski jo vetëm që nuk u dorëzua, por ruajti të njëjtin ritëm edhe këtë edicion duke konfirmuar se është sulmuesi më i mirë në qarkullim. 46 gola ka shënuar Lewandowski deri më tani, 39 gola në Bundesligë, duke lënë pas të gjithë emrat më të rëndësishëm të futbollit, Ronaldo, Messi, Mbappe, Haaland etj. Për herë të parë pas kaq shumë vitesh u përfol se polaku mund të largohej nga Bayerni, por ka qenë vetë sulmuesi që u ka dhënë fund thashethemeve: "Kam një kontratë me Bayernin dhe ndihem shumë mirë këtu. Me Nagelsamann do të hapim një kapitull të ri",



ka thënë Lewndowski për "TuttoSport".

# Westbrooku në histori, thyen rekordin e legjendës Oscar Robertson

ATLANTA, 11 MAJ - U luajtën gjashtë ndeshje në një mbrëmje në NBA, e cila do të mbetet në histori. Sepse Russell Westbrooku u bë lojtari me numrin më të madh të "triple-double" (numër dyshifror në tri aspekte të lojës) në kampionatin më spaktakolar të basketbollit në planet. Ylli i Washington Wizardsit e mbylli takimin ndaj Atlanta Hawksit me "triple-double" e 128 në karrierë e tij: 28 pikë, 21 asistime dhe 13 "rebounde", duke parakaluar një legjendë si Oscar Robertson. Takimi, në fakt, u fitua nga Hawksi me vetëm një pikë diferencë, 125-124, falë 36 pikëve të Trae Young dhe 28 të John Collins. Për Wizardsin nuk mjaftuan plot 45 pikë të realizuara vetëm në periodën e fundit, me Westbrooku që pati mundësi ta shënonte koshin e fitores, por gaboi pikërisht në momentin e rënies së sirenës, raporton "Supersport".



Steph Curry udhëhoqi Golden State Warriorsin në suksesin ndaj Utah Jazzit me rezultatin e ngushtë 119-116. Basketbollisti i lindur në Akron realizoi në total 36 pikë, ku veçohet trepikëshi i fitores vetëm 13 që sekonda para përfundimit të takimit. Në radhët e Jazzit, në mungesë të Donovan Mitchell dhe Mike Conley, spikati Jordan Clarkson me 41 pikë, por që nuk mjaftuan për fitoren për shkak të disa gabimeve radhazi në fundin e ndeshjes. Humbje shkatërruese për Milwaukee Bucksin, që u dorëzua përballë San Antonio Spursit në shifrat 146-125 në një përballje e vendosur që në pjesën e parë, me skuadrën e drejtuar nga Popovichi që udhëhiqte 87-64. Miqve nuk u bënë punë 28 pikët e Giannis Antetokounmposit, ndërsa spursat u frymëzuan nga DeMar DeRozan, autor i 23 pikëve. Me 50 pikë të realizuara vetëm në periodën e parë, Portland Trail Blazers fitoi 140-129 përballë Houston Rocketsit. Damian Lillardi ishte më i miri mbi parket me 34 pikë, ndërsa CJ McCollumi dhe Norman Powelli shtuan nga 28 pikë secili. Blazersi me këtë sukses të rëndësishëm konsolidoi vendin e gjashtë, duke iu larguar rrezikut për të luajtur në play-in. Fitore edhe për Indiana Pacersin në parketin e Cleveland Cavaliersit me rezultatin 111-102 falë 25 pikëve të Kelan Martinit, ndërsa Memphis Grizzliesi iu imponua New Orleans Pelicansit 115-110 me 23 pikë të Dillon Brooksit.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Atlanta Hawks - Washington Wizards | 125-124 |
| Cleveland Cavaliers - Indiana Pacers | 102-111 |
| Memphis Grizzlies - New Orleans P. | 115-110 |
| San Antonio Spurs - Milwaukee Bucks | 146-125 |
| Golden State Warriors - Utah Jazz | 119-116 |
| Portland Trail Blazers - Houston R. | 140-129 |

# PSG-ja përgatitet për transferimin e Messit dhe Ramosit

PARIS, 11 MAJ - Ambicia kryesore e projektit të PSG-së është ta fitojnë titullin e Ligës së Kampionëve dhe synon ta realizojë duke nënshkruar me dy yje botërore, Sergio Ramos dhe Leo Messi. Edhe pse shiheshin si transferime të pamundura shkaku i rregullës financiare, por fakti që do të transferohen si agjentë të lirë e bën këtë 'operacion' të mundshëm. Rinovimi i Neymarit që u arrit të



shtunën e kaluar dhe shitja e Kylian Mbappes te Real Madridi do ta lejonte klubin francez pa dyshim të dominonte në afatin kalimtar veror. Presidenti Al Kehalifi dhe drejtori sportiv Leonardo kanë punuar që të nënshkruajnë me dy futbollistët edhe pse ende nuk dihet nëse lojtarët kanë vendosur të largohen nga Spanja. Messi dëshiron të luajë me Neymarin sërish, por fillimisht do ta dëgjojë ofertën e presidentit Joan Laporta para se të vendosë përfundimisht mbi të ardhmen. Ndërsa Ramosi ka dhënë sinjalet e para, duke filluar t'i ndjekë të gjithë yjet e PSG-së në rrjetet sociale.

## SHKURT

### Zidane shihet si pasardhës i Pirlos në Juventus

Trajneri aktual i Real Madridit, Zinedine Zidane, po shihet si një zëvendësues i mundshëm i Andrea Pirlos te Juventusi. E ardhmja e Pirlos te Juventusi është në pikëpyetje për sezonin e ardhshëm pasi që nuk arriti ta fitoj titullin e dhjetë me radhë në Itali dhe momentalisht janë në pozicion që i mban jashtë garës së Ligës së Kampionëve për sezonin e ardhshëm, shkruan "Marca". Kjo situatë ka krijuar mjaft shumë kritika për trajnerin e Juventusit dhe ka bërë që drejtuesit e klubit ta shohin mundësinë e zëvendësimit të tij. Zidane momentalisht është në garë me Real Madridin për ta fituar titullin e La Ligas ku ndodhen dy pikë larg vendit të parë pas dështimit përball Sevillas në fundjavë.

### Martinezi: Nuk largohem nga Interi

Lautaro Martinez nuk ka ndërmend që të largohet nga Interi gjatë merkatos së verës. Sulmuesi argjentinas në një intervistë që ka dhënë së fundmi për gazetën "Libero" ka konfirmuar se do ta vijojë aventurën me zikaltrit, me ose pa Conten. "Në momentin që po kalojmë, e kam të qartë, do të flas me skuadrën dhe do të gjejmë një zgjidhje. Duhet ta kuptojmë të gjithë së bashku. I nervozuar? Përse duhet të jem, në të vërtetë ne jemi shumë të qetë. Jemi shumë të përqendruar në fushë. Shpresoj që Conte të qëndrojë, në këto dy vjet të gjithë kemi bërë hapa përpara. Ai më pëlqen, por edhe nëse do të largohet unë jam një futbollist i Interit dhe punoj për këtë klub", ka thënë Martinez. Lautaro sezonin e kaluar u kërkua me ngulm nga Barcelona, por duket se tashmë është i bindur nga projekti i zikaltërve.

### Mane: Ky është sezoni më i keq i karrierës time

Liverpooli i këtij sezoni është kopja e shëmtuar e skuadrës që jemi mësuar të shohim në vitet e fundit. Mungesat kanë pasur ndikimin e vet negativ, por djemtë e Jurgen Kloppit kanë bërë gabime të shumta. "The Reds" renditet përkohësisht në vend të gjashtë në Premierë Ligë dhe rrezikojnë seriozisht të mbeten pa Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Sulmuesi senegalez i ekipit, Sadio Mane, ka bërë autokritikë. Në prononcimin e dhënë për Canal +, 29-vjeçari afrikan, i cili këtë sezon numëron 9 gola dhe 6 asistime në kampionat, e pranon se ky ka qenë sezoni më i dobët i karrierës së tij. "Ky është sezoni më i keq i karrierës time, më duhet ta pranoj. Nëse do të më pyesni në lidhje me problemin, unë do të bëja të pamundurën për t'u përgjigjur por, sinqerisht, që nuk ia kam idenë fare. Gjithmonë kam tentuar të jem pozitiv, pavarësisht nëse gjërat në fushë ecin mirë apo jo. Unë jam dyshues dhe skeptik rreth performancave të mia. Kam bërë edhe një test në lidhje me fizikun tim", ka thënë Mane.

## Cavani rinovon kontratën me Unitedin

Sulmuesi Edinson Cavanin ka vendosur të jetë pjesë e Manchester Unitedit edhe për një vjet tjetër. "El Matador" e ka rinovuar kontratën me "Djajtë e Kuq" edhe për një tjetër sezon, kjo ka ardhur pasi futbollisti në fjalë ka bindur drejtuesit e klubit anglez me formën e mirë që ka treguar duke shënuar 8 gola në shtatë ndeshje. "Gjatë sezonit kam grumbulluar një dashuri të madhe për këtë klub dhe gjithçka përfaqëson. Ndiej një lidhje të fortë me shokët e ekipit dhe stafin. Ata më motivojnë çdo ditë dhe e di se së bashku mund të arrijmë gjëra të veçanta. Kam ndier besimin e trajnerit që ditën e parë që erdha. Si lojtar ai besim të jep mundësinë të luash në mënyrë të përkryer futboll dhe e falënderoj për këtë. Jam i prekur për faktin që tifozët duan të qëndroj dhe do të jap gjithçka që t'i bëj të lumtur me paraqitjet e mia në fushë. Ende nuk kam provuar të luaj para tifozëve në 'Old Trafford' dhe mezi pres ta bëj", ka thënë Cavani.

EURO eg GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Golden Eagle Ylli, kampion i Kosovës

Ylli u shpall për herë të parë kampion i Kosovës, pasi në finale triumfoi me seri 3:0. Ylli e nisi ndeshjen më mirë me një epërsi 0:6, por më pas erdhi kundërpërgjigja e pejanëve, që ishin shumë më të mirë në çerekun e parë, ku kishin eëpërsi 24:11, derisa kjo pjesë përfundon 24:14



**Pejë, 11 maj -** Golden Eagle Ylli ka mundur Pejën 67:70 (24:14, 17:20, 13:23, 13:13), në ndeshjen e tretë finale të "play-offit" në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Ylli u shpall për herë të parë kampion i Kosovës, pasi në finale triumfoi me seri 3:0. Ylli e nisi ndeshjen më mirë me një epërsi 0:6, por më pas erdhi kundërpërgjigja e pejanëve, që ishin shumë më të mirë në çerekun e parë, ku kishin eëpërsi 24:11, derisa kjo pjesë përfundon 24:14. Lojë më e baraspeshuar u zhvillua në periudhën e dytë. Mysafirët arrijnë të ngushtojnë shifrat në 32:27, por më pas shkëputen sërish pejanët, kurse pjesa e parë përfundon 41:34. Lojë shumë interesante u zhvillua në periodën e tretë, ku skuadra nga Theranda me kalimin e minutave arrin të shkrijë epërsinë dhe të kalojë në epërsi 52:55, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 54:57. Lojë shumë interesante u zhvillua në 10 minutat e fundit me shumë dramë. Ylli kishte epërsi 59:66, por rikthehet Peja me një seri prej 7:0, duke kaluar në epërsi 67:66. Megjithatë, në momentet vendimtare, therandasit ishin më të vëmendshëm dhe triumfuan 67:70.

# MKRS-ja nënshkruan 18 memorandume bashkëpunimi me federatat sportive

**Prishtinë, 11 maj -** Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrulla Çeku, ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me 18 federata sportive. Memorandumet e bashkëpunimit janë nënshkruar me këto federata: Federatën e Xhudos, Federatën e Futbollit, Federatën e Pingpongut, Federatën e Tenisit, Federatën e Sportit Shkollor, Federatën e Triathlonit, Federatën e Taekwondos, Federatën e Shigjetarisë, Federatën e Shahut, Federatën e Badmintonit, Federatën e Autosporteve, Federatën e Aeronautikës, Federatën e Gjimnastikës, Federatën Skitare, Federatën e Çiklizmit, Federatën e Sporteve Universitare, Federatën e Peshëngritjes dhe Federatën e



Boulingut. Në tre takimet që u mbajtën sot mori pjesë zëvendësministrja Daulina Osmani e cila specifikoi se federatat me norma olimpike do të mbështeten përtej bazës së memorandumeve të nënshkruara. Mbështetja financiare e zotuar përmes memorandumeve të nënshkruara arrin shumën 829,129.00 euro. Në këtë periudhë federatat do ta pranojnë gjysmën e vlerës së memorandumit, ndërsa pagesat e tjera do të procedohen në tremujorin e tretë dhe të katërt. Deri në fund të javës do të vazhdojë nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me federatat e tjera sportive.

# Iniesta nuk ndalet, rinovon me Vissel Koben

**Kobe, 11 maj -** Andres Iniesta nuk ka ndërmend të tërhiqet nga futbolli i luajtur. Ish-ylli i Barcelonës i dhuroi vetes për ditëlindjen e 37 rinovimin e kontratës me skuadrën e Vissel Kobes, pjesë e së cilës është nga viti 2018. Mesfushori ka nisur sezonin e tij të 4-t në Japoni dhe vendosi ta zgjaste qëndrimin duke firmosur deri në fund të vitit 2023. Iniesta gjatë karrierës së tij ka luajtur 442 ndeshje me Barcelonën derisa ka realizuar 32 gola.



## Daku: Ndjenjë e papërshkruar që ta thyej rekordin si golashënuesi më i mirë brenda një sezoni

**Suharekë, 11 maj -** Mirlind Daku ka thyer rekordin e golave brenda një sezoni në histori të futbollit të Kosovës. Sulmuesi gjilanas i Ballkanit ka shënuar 28 gola deri më tani, teksa ka edhe dy xhiro për të përfunduar ky edicion garash. Sulmuesi i Ballkanit ka thënë se është ndjenjë e papërshkruar që të thyejë këtë rekord të madh. Ai ka falënderuar presidentin e Ballkanit, Arsim Kabashi, si dhe trajnerët Ismet Munishi e Bledi Shkëmbi, por edhe bashkëlojtarët e tij. "Ndjenjë e papërshkruar që ta thyej rekordin si golashënuesi më i mirë brenda një sezoni në historinë e futbollit kosovar. Dua ta falënderoj klubin tim Ballkanin, trajnerët Ismet Munishi dhe Bledi Shkëmbi, presidentin Arsim Kabashi si dhe gjithë bashkëlojtarët e mi që pa ta këta gola nuk do të ishin. Qëllimi ishte titulli i kampionit, por rrethanat ishin asisoj që nuk ia dolëm. Faleminderit Suharekë! Faleminderit të gjithëve!", ka thënë Daku.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **" EFFECTIVE GROUP " SH.P.K.** me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të unik identifikues: **811389049** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kane raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBVASTENJE

Obavještavamo sve klijente da Tvrtka **" EFFECTIVE GROUP " DOO** u Prizren doneu odluku da ugasi biznis po br. Registra: **811389049** i ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postuaka likfidacije. Obvastavaju se svi klienti koji imaju obaveze i oitrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanjo o nevice.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **" EFFECTIVE GROUP " L.L.C** in Prizren has come to the decision to quit its business with registry: **811389049**. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

---

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " I. Seferi" Sh.p.k.Gjinoc, Suharekë , në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin, thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Z. K. Studençan, Suharekë. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.06.2021 në ora 10:00 në Restaurant "DONI",Lokacioni: Fshati Gjinoc, kilometri i 6-të në Magjistralen Suharekë-Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania " I. Seferi" Sh.p.k.Gjinoc, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin, thermimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Z.K. Studençan, Suharekë.
Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOm Linku:
https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " I. Seferi" Sh.p.k.Gjinoc, Suharekë për eksploatimin, thermimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Z.K. Studençan, Suharekë.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

---

## Local publication for call for proposals

**Cross Border Cooperation Programme Montenegro – Kosovo**

**2014-2020**

**EuropeAid/171521/ID/ACT/MULTI**

Ministry of Finance and Social Welfare of Montenegro, the Directorate for Finance and Contracting of the EU Assistance Funds is seeking proposals for promoting good neighbourly relations, fostering European Union integration and promoting socio-economic development in Montenegro/Kosovo with financial assistance from the „Cross Border Cooperation Programme Montenegro – Kosovo for the years 2014-2020", financed by the Instrument for Pre-Accession – IPA II. The full guidelines for applicants are available for consultation at http://www.cfcu.gov.me/en/tenders and on the following internet site: https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome. The deadline for submission of proposals is 25th June 2021, before 14:30 hours local time.

Notice on information session on this Call for Proposals will be published after publishing call for proposals on the website of the Contracting Authority: http://www.cfcu.gov.me/en/tenders and on the website of DG for International Partnerships https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome.

---

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**
**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 5353/20 të datës 30.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

FTESË PËR OFERTË

datë:12.05.2021
"EBE" SH.P.K.
Tel.+38349207580
e-mail:q.hoti@yahoo.com
NUI.811150614
Adresa"objekti afarist "DARDANIA",rruga "R. Kombëtare",pn.,Malishevë
Objekti I kontratës:**"Improved competitveness of fruits producers through estabilishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"**
Të nderuar Zonja/zotëri, :EBE SH.P.K. ju fton që të paraqitni ofertën tuaj për zbatimin e projektit të bashkë financuar nga EU dhe EBE sh.p.k., **"Improved competitveness of fruits producers through estabilishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards", Furnizimi me piruner elektrik**
Kriteret e përzgjedhjes:Tenderi me çmimin më të ulët
Kontrata do të konsistoj në kryerjen e furnizimeve për implementimin e projektit të lartë cekur
Lloji I kontratës:Furnizim
INFORMACIONET ADMINISTRATIVE
Afati I fundit për pranimin e kërkesave për dosje data:28.05.2021
Dokumentet per ofertim munde te merren ne formë elektronike ne adresen, q.hoti@yahoo.com
Afati kohor për pranimin e ofertave: data 02.06.2021,deri në orën 13,vendi në objektin afarist Daradania ne rrugën Rilindja Kombëtare pn,Malishevë.
Ofertat e sjellura pas ores 13 nuk do te pranohen.
Takimi per hapjen e ofertave:data 02.06.2021,koha 13:30h ,vendi në objektin afarist "Dardania" në rrugën "R. kombëtare" Malishevë.
Vlera e parashikuar : 31,000.00 €
informacionet plotsuese nga data 17.05.2021 deri me daten 28.05.2021 gjat diteve te punes

IVITATION OFFER

Date:12.05.2021
"EBE"LLC
Tel.+38349207580
e-mail:q.hoti@yahoo.com
UIN.811150614
Address "DARDANIA"Building,street "R. Kombëtare",pn.,Malishevë
€Aim of thr contract:**"Improved competitveness of fruits producers through estabilishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"**
Dear Mr/Mrs
"EBE"LLC. Invites you to present your offers for the execution of the the project co founded by EU and EBE LLC for :**"Improved competitveness of fruits producers through estabilishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards", supply of electric forklift**
Selection Criteria:The lowest price tendering
The contract will consist of services and supplies for the implementation of the above mentioned project
Type of contract: supply
Administrative information
The deadliner for submission of requests and bid offers is on: 28.05.2021
The tendering documents can be received via electronic at: q.hoti@yahoo.com
Deadline for receiving offers:date 02.06.2021 to 13:00 Am in the building"Daradani" street "R. Kombëtare" Malishevë.
Offers submitted after 13:00 Am will not be accepted.
Meeting for the opening of the offers :date 02.06.2021 ,time 13:30 Am,building locatin "Dardania" street "R.Kombëtare" Malishevë
The estimated value :31,000.00 €
Additional information on: 17.05.2021 to 28.05.2021 during working days.

## Njoftim/shpallje

Njoftohen institucionet se me ka humbur certifikata origjinal e Arbk-se për biznesin me emrin tregtar DPSH "Horizonti" me numër të biznesit: 70844303 dhe numër Unik identifikues: 811246603 me emër të biznesit "Bashor Buzhala" B.I, Komuna Klinë.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Kushtrim Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.

▶ Fitore Qatani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmle " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Berat Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmle " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Hasan Maloku shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L